



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1689/5 prot.

Datë 13.08.2026

V E N D I M
Nr. 973/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Ismail Shehu	Kryetar
Edvin Simo	Anëtar
Nertil Kanina	Anëtar

Në mbledhjen e datës 13.08.2026 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “NISATEL” ShPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-83798-04-29-2026, me objekt “Shërbim interneti për 3 vite”, me fond limit 5,420,339.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 11-05-2026 nga autoriteti kontraktor Autoriteti Portual Durrës.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Ubi Group” Sh.p.k në procedurën e prokurimit sipërcituar.

Lënien të skualifikuar të operatorëve ekonomike Abissnet Sh.A, ASC SHPK, dhe NISATEL SHPK, në procedurën e prokurimit sipërcituar.

Autoriteti Kontraktor: Autoriteti Portual Durrës, me adresë: Lagja 1, Rruga Tregtare, Durrës.

Ankimues: Operatori ekonomik “NISATEL” ShPK me NIPT K26330201T, Adresa: Lagjja Pavarësia Kulla e parë tek Rrethi Skelë kati 2 , Vlore.

Operatori ekonomik “ONE ALBANIA” SH.A me NIPT J61814094Ë, Adresa: Njesia Bashkiake Nr.11, Rruga Vangjel Noti , Ndertesa Nr.20, 1026, Laprakë , Tirane.

Subjekt i Interesuar: Operatori ekonomik “Ubi Group” Sh.p.k, me Nipt L61311515A, Adresa: Lagjja nr. 6, Rruga Aleksander 2 Goga, Pallati nr. 441, Kati i parë Durrës.

Abissnet Sh.A, me NIPT: K01417001C, Tiranë Njesia Bashkiake Nr.5, Rruga Ismail Qemali, Pallati 18, Kati II.

ASC SHPK, me NIPT K62115018I, Njesia bashkiake nr 6, rruga Fabrika e Qelqit, zona kadastrale 8230, nr pasurie 2/63, godina qendrore, Tiranë.

NISATEL SHPK, me NIPT K26330201T, Adresa: Lagjja Pavarësia Kulla e parë tek Rrethi Skelë kati 2 , Vlore.

Baza Ligjore: Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”,

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi, se këta të fundit kanë qenë operatorë ekonomikë në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.3. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.4. Operatorët ekonomik ankimues kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.5. Ankimuesit kanë plotësuar kushtet formale të paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 30-04-2026 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-83798-04-29-2026, me objekt “Shërbim interneti për 3 vite”, me fond limit 5,420,339.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 11-05-2026 nga autoriteti kontraktor Autoriteti Portual Durrës.

II.2. Në datën 11-05-2026, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), autoriteti kontraktor më datë 15.05.2026, ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1.“ALBANIAN SATELLITE COMMUNICATIONS” SHPK	2,908,800 lekë Skualifikuar
2.“ABISSNET” SH.A	3,198,600 lekë Skualifikuar
3.“UBI GROUP” SHPK	3,580,000 lekë Kualifikuar
2.“NISATEL” SHPK	3,888,888 lekë Skualifikuar
6.“ONE ALBANIA” SHA	4,105,260 lekë Kualifikuar

- | | |
|--|----------------------------|
| 7. “VODAFONE ALBANIA” Sh. | 4,599,972 lekë Kualifikuar |
| 8. “ALBANIAN TELECOMMUNICATIONS UNION” SHPK & “DIGICom” sh.p.k | 4,615,100 lekë Kualifikuar |
| 9. “Albanian Fiber Telecommunications” | 4,887,986 lekë Kualifikuar |

II.4. Në datën 25.05.2026, autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit paraprak.

II.5. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kontraktor është depozituar ankesa me numër ankimimi elektronik A/2026/6732, datë 29.05.2026 dhe me Nr. 1689/2026 Prot., date 29.05.2026, nga operatori ekonomik “NISATEL” ShPK, për procedurën e prokurimit, “E Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF 83798-04-29-2026, me objekt “Shërbim interneti për 3 vite”, me fond limit 5,420,339.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 11-05-2026 nga autoriteti kontraktor Autoriteti Portual Durrës.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “*Veprimet paraprake*” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr.1689/1 prot, datë 01.06.2026, lidhet me kundërshtimin e vendimmarrjes së Komisionit të Vlerësimit të Ofertave skualifikimin e ofertës 1 të paraqitur nga operatori ekonomik “NISATEL” ShPK si edhe kundërshtimin e kualifikimit të operatorit ekonomik “Ubi Group” Sh.p.k në procedurën e prokurimit sipërcituar.

II.7. Autoriteti kontraktor nëpërmjet shërbimit postar, ka përcjellë me shkresën nr. 1925 prot., datë 04.06.2026, protokolluar me tonën me nr. 1689/2 prot., datë 08.06.2026, vendimin e KSHA-së, mbi trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “NISATEL” SHPK. Referuar shkresës së sipërcituar të Autoritetit kontraktor, rezulton, se ky i fundit ka vendosur refuzimin e ankesës.

II.8. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kontraktor është depozituar ankesa me numër ankimimi elektronik A/2026/6735, datë 29.05.2026 dhe me Nr. 1694/2026 Prot., date 01.06.2026, nga operatori ekonomik ONE ALBANIA SHA, për procedurën e prokurimit, “E Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-83798 04-29-2026, me objekt “Shërbim interneti për 3 vite”, me fond limit 5,420,339.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 11-05-2026 nga autoriteti kontraktor Autoriteti Portual Durres.

II.9. Në përputhje me nenin 112 “*Veprimet paraprake*” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën

e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr.1694/1 prot, datë 01.06.2026, lidhur me kundërshtimin e vendimmarrjes së Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “UBI GROUP” ShPK si edhe Lenien te skualifikuar te operatoreve ekonomike Abissnet, ASC dhe NISATEL sh.p.k me arsyet e parashtruara nga ana e AK, në procedurën e prokurimit sipërcituar.

II.10. Autoriteti kontraktor, ka përcjellë me shkresën nr. 1926 prot., datë 04.02.2026, protokolluar me tonën me nr.1694/2 prot., datë 08.06.2026, vendimin e KSHA-së, mbi trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimes “ONE ALBANIA” SHA. Referuar shkresës së sipërcituar të Autoritetit kontraktor, rezulton, se ky i fundit ka vendosur mos pranimin e ankesës se sipërcituar.

II.11. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se ne datë 15.06.2026 me shkresën e protokolluar me tonën nr.1694/3, datë 15.06.2026, janë dorëzuar nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimeve argumente nga operatori ekonomik “ONE ALBANIA” SHA, për procedurën e prokurimit të sipërcituar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur tyre, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me ankesën nr. A/2026/6732, datë 29.05.2026 dhe me Nr. 1689/2026 Prot., date 29.05.2026, nga operatori ekonomik “NISATEL” ShPK, mbi kundërshtimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së paraqitur prej tyre, me arsyen se: *“...-Sqarim mbi sigurimin e ofertës Në lidhje me arsyen e skualifikimit për dokumentin e sigurimit, sqarojmë se vullneti i operatorit ekonomik ka qenë i qartë, i dokumentuar dhe i lidhur drejtpërdrejt me përmbushjen e kriterit të sigurimit të ofertës. Ky fakt provohet nga komunikimi elektronik i datës 06.05.2026, ora 12:47, dërguar nga përfaqësuesja e Nisatel sh.p.k. pranë shoqërisë së sigurimit SIGAL, me subjekt Sigurim oferte . Në këtë komunikim kërkohet shprehimisht: Na duhet sigurim i ofertës për Tenderin: Autoriteti Portual Durrës . Në të njëjtin komunikim janë përcaktuar saktë të gjitha të dhënat thelbësore të procedurës: autoriteti*

kontraktor, objekti i prokurimit, fondi limit, numri i referencës dhe shuma e sigurimit të ofertës. Pra kërkesa e operatorit ekonomik drejtuar shoqërisë së sigurimit nuk ka qenë për sigurim kontrate, por për sigurim oferte. Pse kemi gabim material dhe jo mospërmbushje të kriterit Nëse në dokumentin e lëshuar nga shoqëria e sigurimit është përdorur gabimisht emërtimi sigurim kontrate në vend të sigurim oferte, ky fakt duhet të trajtohet si gabim material/formal në emërtim, jo si mungesë e sigurimit të ofertës. Thelbi i dokumentit dhe i komunikimit provues është i saktë: procedura është e njëjta, autoriteti kontraktor është i njëjti, objekti është i njëjti, numri i referencës është i njëjti dhe vlera e sigurimit është ajo e kërkuar në dokumentet e tenderit. Për rrjedhojë, gabimi nuk prek përmbajtjen thelbësore të garancisë dhe nuk krijon asnjë avantazh konkurrues për operatorin ekonomik. Në këtë rast nuk kemi mungesë dokumenti, nuk kemi mungesë vlere, nuk kemi dokument të lidhur me procedurë tjetër dhe nuk kemi ndryshim të ofertës ekonomike. Kemi vetëm një pasaktësi në titullimin/emërtimin e dokumentit nga shoqëria e sigurimit, ndërkohë që përmbajtja dhe rrethanat provuese tregojnë qartë se dokumenti është kërkuar për sigurimin e ofertës. III. Baza ligjore dhe parimi i proporcionalitetit Në kuptim të ligjit nr. 162/2020 Për prokurimin publik, vlerësimi i ofertave duhet të bëhet në respektim të parimeve të barazisë së trajtimit, transparencës dhe proporcionalitetit. Skualifikimi është masë e rëndë dhe duhet të përdoret vetëm kur mospërputhja cenon realisht kriterin, garën ose sigurinë juridike të procedurës. Kur dokumenti i paraqitur lidhet me procedurën konkrete dhe përmban të dhënat thelbësore të kërkuara, ndërsa gabimi qëndron vetëm në emërtimin formal, autoriteti kontraktor nuk duhet të ndalet vetëm te titulli i dokumentit, por duhet të vlerësojë përmbajtjen reale, efektin juridik dhe provat shoqëruese. Komunikimi elektronik i datës 06.05.2026 provon në mënyrë të drejtpërdrejtë se operatori ekonomik ka kërkuar sigurim oferte dhe ka dhënë të dhënat e sakta të procedurës. Ky provim e përjashton mundësinë që operatori të ketë synuar të paraqesë një dokument tjetër apo të shmangë detyrimin e sigurimit të ofertës. Për rrjedhojë, skualifikimi mbi këtë bazë do të ishte disproporcional, formalist dhe i pabazuar në efektin real të dokumentacionit të paraqitur. Bashkëlidhur: Komunikimi elektronik me shoqërinë e sigurimit Më poshtë bashkëlidhet komunikimi elektronik i datës 06.05.2026, ora 12:47, me subjekt Sigurim oferte, nga i cili rezulton kërkesa e qartë për lëshimin e sigurimit të ofertës për procedurën e Autoritetit Portual Durrës. Figura 1. Emaili provues për kërkesën e sigurimit të ofertës.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në pikën seksionin 3 “Seksioni 3: Informacione juridike, ekonomike, financiare dhe teknike”, të dokumentave të tenderit, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

“3.1 Sigurimi i ofertës: (e zbatueshme në rastin e procedurave të prokurimit me një vlerë më të lartë se sa prokurimi me vlerë të vogël).

Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Sigurimit të Ofertës, sipas Shtojcës 3.

Shuma e sigurimit të ofertës është **108,406.78 (njëqind e tetë mijë e katërqind e gjashtë presje shtatëdhjetë e tetë) lekë.**

Në rastet e paraqitjes së ofertave për Lote të veçanta, vlera e sigurimit të ofertës për secilin Lot do të jetë si më poshtë:

Loti 1 _____ (shuma,monedha)
Loti 2 _____ (shuma monedha)”

3.1.3 Autoriteti kontraktor pranon pagesën e vlerës së sigurimit të ofertës nga ofertuesi edhe në formën:

i. garancisë bankare **X**

ose

ii. nga shoqëri sigurimi të licencuara nga autoritetet kompetente **X**

3.2 Periudha e vlefshmërisë së ofertës: 150 (njëqind e pesëdhjetë) ditë

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar

shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]"

III.1.2. Në përmbushje të kriterit të mësipërm, OE ankimes "NISATEL" SHPK, ka dorëzuar në pranë autoriteti kontraktor dokumentacionin fizik si më poshtë:



FORMULARI I SIGURIMIT TË KONTRATËS

Nr. i serisë: Nr. 26

[Ref: REF-83798-04-29-2026]
[Data: 06/05/2026]

Për: "AUTORITETI PORTUAL DURRES, AL"

Në emër të: "NISATEL, NIPT K26330201T"

Procedura e Prokurimit (nëse zbatohet): Procedurë e hapur

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: Shërbim interneti për 3 vite

Publikimi (nëse zbatohet): www.app.gov.al

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne **SIGAL INSURANCE GROUP**, Tiranë jemi Garantues të NISATEL, NIPT K26330201T për një vlerë prej si kusht për sigurimin e ekzekutimit të kontratës, që do të nënshkruhet me AUTORITETI PORTUAL DURRES.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e AUTORITETI PORTUAL DURRES vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mos-përmbushjen e kushteve të kontratës.

Ky Sigurim është i vlefshëm deri në zbatimin plotë të kontratës por jo më vonë se 06/05/2027. (nëse është shprehur me datë në "njoftimin e fituesit")

Lëshuar më 06/05/2026, në përputhje me Autorizimin Nr. 2, datë 23.06.1999, pika 7, lëshuar nga Komisioni i Mbikqyrjes së Sigurimeve, mbështetur në dispozitat e Ligjit Nr. 8081, datë 07.03.1996 ndryshuar me Ligjin Nr. 52/2014, datë 22.05.2014 "Mbi Veprimtarinë e Sigurimeve dhe Risigurimeve".

Nënshkruar nga: **SIGURUESI**

III.1.3 Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.1.4. Në neni 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.1.5. Në nenin 77, pika 1 dhe 3 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.
- Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet

kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë

një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në

fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre

vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiron vjetore minimale që kërkohej nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e

vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohej operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë

një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.1.6. Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha

kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.1.7. Në neni 83, pika 1 dhe 2 “Sigurimi i ofertës” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: *“1. Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël. Në rastin e kontratave sektoriale, enti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, ndërkohë që mund të kërkojë paraqitjen e këtij sigurimi edhe në procedurat nën kufirin e lartë monetar, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël. 2. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit: a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlllogaritur të kontratës; b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor pranon mundësinë e pagesës nga ofertuesi, në vlerë monetare në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor. Përveç kësaj forme të paraqitjes së sigurimit të ofertës, autoriteti ose enti kontraktor, sipas vlerësimit të tij, duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit mundësinë e paraqitjes së sigurimit të ofertës: i. në formën e garancisë bankare; ose ii. nga shoqëri sigurimi të licencuara nga autoritetet kompetente.”.*

III.1.8. Në nenin 30 pika 3 “Sigurimi i ofertës” të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se: *“3. Autoriteti/enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit vlerën e sigurimit të ofertës, e cila është sa 2% e vlerës së fondit limit të kontratës ose lotit. Në dokumentet e tenderit duhet të parashikohet një periudhë vlefshmërie, bazuar në kohëzgjatjen e mundshme të procedurës. Sigurimi i ofertës duhet të jetë i vlefshëm gjatë gjithë kësaj periudhe.”.*

III.1.9. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, vërehet se në kriterin kualifikues të njoftimi i shkurtuar i Kontratës të dokumenteve të tenderit, autoriteti kontraktor sipas parashikimeve të ligjore ka parashikuar që Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Sigurimit të Ofertës, sipas Shtojcës 4 si dhe në pikën 3.2 të dokumentave standarte të tenderit ka parashikuar “Periudha e vlefshmërisë së ofertës: 150 dite”.

III.1.10. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Komisioni i Prokurimit

Publik konstaton, se referuar “Formularit të Sigurimit të Ofertës” të kërkuar nga autoriteti kontraktor dhe formularit të dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues “NISATEL” SHPK, nuk është lëshuar sipas formatit të kërkuar në shtojcën 3 të dokumentave të tenderit dhe të cituar në pikën III.1.1 të këtij vendimi të përcaktuara në kriterin kualifikues të sipërpërmendur. Konkretisht nga shoqëria e licencuara nga autoritetet kompetente dhe përkatësisht shoqëria e sigurimit “ALBSIG” SHA, dhe nëpërmjet operatori ekonomik “NISATEL” SHPK është dorëzuar formulari i sigurimit të kontratës të lëshuar nga kjo shoqëri dhe jo përkatësisht formulari i kërkuar i sigurimit të ofertës. Komisioni gjykon se ky formular nuk është si kërkuar nga autoriteti kontraktor në shtojcën 3 të dokumentave të tenderit. Lidhur me arsyen e skualifikimit të dhënë nga autoriteti kontraktor për operatorin ekonomik ankimues “NISATEL” SHPK, Komisioni vëren, se arsyja e skualifikimit është e lidhur me formularin e sigurimit të ofertës së tij, duke pretenduar se nuk ka siguruar ofertën e tij sipas shtojcës 3 të kërkuar nga ligji si dhe të përcaktuar në dokumentet e tenderit, pasi formulari i sigurimit të ofertës është i ndryshëm nga ai i sigurimit të kontratës të dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni gjykon, se ndodhur në këto kushte formulari i sigurimit të ofertës të paraqitur nga ankimuesi, i cili është lëshuar nga shoqëria e sigurimeve ALBSIG, nuk është sipas formatit të kërkuar nga autoriteti kontraktor sic parashikohet dhe në nenin 83 pika 2 e ligjit “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe rrjedhimisht ankimuesi me dokumentacionin e dorëzuar nuk e ka plotësuar kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 3.1, të dokumenteve të tenderit.

Për sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “NISATEL” SHPK nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues “NISATEL” SHPK për arsyet e tjera të skualifikimit të ofertës së dorëzuar prej tij por edhe për pretendimet mbi kundërshtimin e kualifikimit të operatorit ekonomik “Ubi Group” SHPK, KPP referuar gjykimin mësipër në pikën III.1.10., gjykon se nuk do të merren në shqyrtim për ekonomi të procedurës administrative pasi, gjendja faktike dhe juridike e këtij operatori ekonomik do të vijojë të ngelet e skualifikuar edhe pas ankimit në KPP, duke mos pasur më interes të ligjshëm në lidhje me pretendimet e tjera dhe për operatorët e tjerë ekonomik në këtë procedurë prokurimi.

III.3. Lidhur me ankesën nr. A/2026/6735, datë 29.05.2026 dhe me Nr. 1694/2026 Prot., date 01.06.2026 e operatorit ekonomik “ONE ALBANIA” SHPK, mbi lënien të skualifikuar të operatorëve ekonomikë Abissnet, ASC dhe NISATEL sh.p.k me arsyet e parashtruara nga ana e AK, nuk do të merren në shqyrtim për ekonomi të procedurës administrative pasi për operatorin ekonomik “NISATEL” SHPK referuar gjykimin mësipër në pikën III.1.10., gjendja faktike dhe juridike e operatorit ekonomik “NISATEL” sh.p.k. do të vijojë të ngelet e skualifikuar nga procedura në fjalë duke e përmbushur kështu kërkesën e operatorit ekonomik ankimues. Përsa i përket operatoreve të tjerë ekonomik “Abissnet” SHA dhe “ASC” SHPK gjithashtu do vijojnë të mbeten të skualifikuar pasi pas ankesave të administruara pranë KPP nuk janë paraqitur argumenta në cilësinë e operatoreve ekonomik të interesuar në përputhje me nenin 113 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar për procedurën e prokurimit duke mos ndryshuar kështu gjendjen e tyre faktike dhe juridike nga të qënurit të skualifikuar, e rrjedhimisht në këtë pikë pa ndonjë interes për ankimuesin.

III.4. Lidhur me pretendimin tjetër të operatorit ekonomik “ONE ALBANIA” SHPK, mbi kundërshtimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me kualifikimin e ofertës së paraqitur prej operatorit ekonomik “UBI GROUP” SHPK, me arsyen se: “Konkretisht UBI Group nuk plotëson kriteret si më poshtë: 1. Referuar pikes 2.3 Kapaciteti teknik: 2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % nga vlera e përllogaritur e fondit të limit të kësaj kontrate. Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme: Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohej vërtetimi të lëshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të furnizimit e realizuara. Faturat të jenë të deklaruara në organet tatimore. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të furnizimit e realizuara. Faturat të jenë të deklaruara në organet tatimore. Duke qene se ky operator ka një veprimtari primare ndryshe nga ajo që po prokurohet pra: Tregeti import-eksport artikuj të ndryshëm industrial dhe të tjere, (aparate telefonike, kamera, kompjutera dhe aksesori për to, karta rimbushëse numra, automjete etj). Shërbime riparime celulare, pagesa dhe rimbushje elektronike, si dhe rishitje të shërbimeve kompanive të tjera. Shërbime për montim e mirëmbajtje sistemesh, kondicionere të kamere, artikuj elektrik dhe elektronike. Qira dhënie marrje të asteve të luajtshme dhe të paluajtshme etj. Riparim dhe mirëmbajtje fotokopjesh, rrjetesh kompiuterike dhe riparime elektronike. Agjent i shoqërisë Easypay shpk (Institucion i Parase Elektronike), për kryerjen e shërbimeve që përfshijnë por nuk kufizohen në pagesa faturash, shitje të mallrave dhe shërbimeve të partnerëve të Easypay, rimbushje elektronike, etj. Shitje dhe blerje për automjetet e përdorura. Transport udhëtarësh me shërbim Taksi (4+1). Agjent në sigurime. Ofrim i rrjeteve dhe shërbimit internet, qartazi ky operator nuk ka kapacitet për të provuar se ka eksperiencë të ngjashme në shërbimet e kërkuara në procedurën e prokurimit. Ky operator nuk mund të ushtrojë dhe leshojë fatura për shërbime të cilat nuk janë objekt i veprimtarisë pranë rregjistrimit të qendrës kombëtare të biznesit. Sa më sipër ky operator është kualifikuar pa të drejtë pasi nuk plotëson kriteret e përcaktuara në procedurën e prokurimit.” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.4.1. Në shtojcën 9 “Formulari i Kriterëve të Përzgjedhjes/Kualifikimit” pika 2.3.1 “Kapaciteti teknik” autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin kualifikues si më poshtë vijon:

“2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % nga vlera e përllogaritur e fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohen **vërtetime** të lëshuara nga një ent publik ose **fatura tatimore** të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të furnizimet e realizuara. Faturat të jenë të deklaruara në organet tatimore.
- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm **fatura tatimore** të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të furnizimet e realizuara. Faturat të jenë të deklaruara në organet tatimore.”

III.4.2. Në përmbushje të kriterit të mësipërm, operatori ekonomik “UBI GROUP” shpk ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), dokumentacionin si më poshtë:

- Faturë tatimore shitje elektronike xxxxxxxxxxxx Data xxxxx, me objekt: “Sherbim Interneti”, me vlerë xxxxx leke pa TVSH.
- Faturë tatimore shitje elektronike nr. xxxxxxxxxxxx Data xxxxx, me objekt: “Sherbim Interneti”, me vlerë xxxxx leke pa TVSH.
- Faturë tatimore shitje elektronike nr. xxxxxxxxxxxx Data xxxxx, me objekt: “Sherbim Interneti”, me vlerë xxxxx leke pa TVSH.
- Faturë tatimore shitje elektronike nr. xxxxxxxxxxxx Data xxxxx, me objekt: “Sherbim Interneti”, me vlerë xxxxx leke pa TVSH.
- Faturë tatimore shitje elektronike nr. xxxxxxxxxxxx Data xxxxx, me objekt: “Sherbim Interneti”, me vlerë xxxxx leke pa TVSH.
- Faturë tatimore shitje elektronike nr. xxxxxxxxxxxx Data xxxxx, me objekt: “Sherbim Interneti”, me vlerë xxxxx leke pa TVSH.
- Faturë tatimore shitje elektronike nr. xxxxxxxxxxxx Data xxxxx, me objekt: “Sherbim Interneti”, me vlerë xxxxx leke pa TVSH.
- Faturë tatimore shitje elektronike nr. xxxxxxxxxxxx Data xxxxx, me objekt: “Sherbim Interneti”, me vlerë xxxxx leke pa TVSH.
- Faturë tatimore shitje elektronike nr. xxxxxxxxxxxx Data xxxxx, me objekt: “Sherbim Interneti”, me vlerë xxxxx leke pa TVSH.
- Faturë tatimore shitje elektronike nr. xxxxxxxxxxxx Data xxxxx, me objekt: “Sherbim Interneti”, me vlerë xxxxx leke pa TVSH.
- Faturë tatimore shitje elektronike nr. xxxxxxxxxxxx Data xxxxx, me objekt: “Sherbim Interneti”, me vlerë xxxxx leke pa TVSH.
- Faturë tatimore shitje elektronike nr. xxxxxxxxxxxx Data xxxxx, me objekt: “Sherbim Interneti”, me vlerë xxxxx leke pa TVSH.
- Faturë tatimore shitje elektronike nr. xxxxxxxxxxxx Data xxxxx, me objekt: “Sherbim Interneti”, me vlerë xxxxx leke pa TVSH.
- Faturë tatimore shitje elektronike nr. xxxxxxxxxxxx Data xxxxx, me objekt: “Sherbim Interneti”, me vlerë xxxxx leke pa TVSH.
- Faturë tatimore shitje elektronike nr. xxxxxxxxxxxx Data xxxxx, me objekt: “Sherbim Interneti”, me vlerë xxxxx leke pa TVSH.

- Faturë tatimore shitje elektronike nr. xxxxxxxxxxxx Data xxxxx, me objekt: “Sherbim Interneti”, me vlerë xxxxx leke pa TVSH.
- Faturë tatimore shitje elektronike nr. xxxxxxxxxxxx Data xxxxx, me objekt: “Sherbim Interneti”, me vlerë xxxxx leke pa TVSH, etj.



pdf_fatura_2.pdf



pdf_fatura_1.pdf

III.4.3. Në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim” pika 4 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

“4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

III.4.4. Neni 41 pika 3 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve”, e VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

“3. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e procedurave të prokurimit “Shërbim konsulence”, si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit.”.

Ndërsa në nenin 92/3 të të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar përcaktohet se: *“3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”*

III.4.5. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 dhe 3 të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik” i ndryshuar ka për detyrë të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dhe të garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

III.4.6. Sqarojmë, se referuar rregullave të prokurimit publik, për kontratat e shërbimeve, për të provuar përvojën e ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë parashikimet e përcaktuara në nenin 41, pika 3 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, ku për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës dhe për të gjykuar në lidhje me përmbushjen apo jo nga ana e operatorit ekonomik “UBI GROUP” SHPK të kriterit më sipër lidhur me përvojën e mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimit. Për përmbushjen e kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.1 të kapacitetit teknik të dokumenteve standarde të tenderit, për përvojë të ngjashme të kryer gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, operatori ekonomik ankimes ka paraqitur dokumentacionin e cituar në pikën III.4.1. të këtij vendimi. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ngarkuar në sistem nga operatori ekonomik “UBI GROUP” SHPK për të dëshmuar përvojën e mëparshme të ngjashme të kryer gjatë tre viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës, KPP gjykon të ndalet në një analizë të thelluar të dëshmive të eksperiencës së ngjashme të dorëzuar nga ankimesi, parë

kjo në rrafshin krahasimor me shërbimet e hartuar nga autoritetit kontraktor, për sa i përket 3 komponentëve, si komponenti kohë (ku Komisioni për këtë komponent do të marrë në konsideratë ato kontrata të cilat janë brenda afatit kohorë 3 vjeçar nga data publikimit të njoftimit të kontratës), komponenti vlerë (lidhet me madhësinë e kontratës ose kontratave të kërkuara nga autoriteti kontraktor në kriterin 2.3.1 pra shërbime të mëparshme të ngjashme ku vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës) si dhe komponentit natyrë e ngjashme (i cili lidhet me natyrën e ngjashme të kontratave të dorëzuara nga ankimuesi me objektin e prokurimit nisur jo vetëm nga emërtesa e kontratës por edhe nga zërat e preventivave të tyre). Gjithashtu, me akt nënligjor, diskrecioni i vendosur nga ligji është rregulluar edhe më tej, ku në rastin e kontratave të shërbimeve, ligjvënësi në nenin 41, pika 3 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, ka parashikuar, mënyrën se si ky kriter përmbushet në rastin e përvojës së ngjashme të mëparshme të realizuar me sektorin publik apo me sektorin privat. Duke iu kthyer kriterit, KPP konstaton, se kriteri i hartuar nga ana e autoritetit kontraktor është në përputhje me diskrecionin e dhënë nga ligji dhe akti nënligjor, afati i kërimit të dokumentacioni është brenda periudhës 3 vjeçare si dhe vlera e kërkuar është brenda kufijve të vlerës sikundër parashikohet edhe në VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Në këtë kuadër siç është cituar më sipër në këtë vendim. KPP nga shqyrtimi dhe verifikimi i të gjitha elementeve të kontratave të dorëzuara nga ankimuesi për përmbushjen e kriterit për përvojën e mëparshme të ngjashme, duke nisur që nga objekti i tyre, vërtetimi i realizimit, përshkrimi i shërbimeve në faturë tatimore si pjesë përbërëse e kontratave, si dhe afatit të realizimit të tyre, nga të gjitha dokumentet e dorëzuara në sistemin e prokurimeve elektronike nga operatori ekonomik për vërtetueshmërinë e përmbushjes së kriterit të përcaktuar në pikën 2.3.1 të kapacitetit teknik të dokumenteve standarde të tenderit, mori në shqyrtim të gjitha faturat e përcaktuara në pikën III.4.2 të këtij vendimi. Komisioni Prokurimit Publik do të marrë në shqyrtim në themel dokumentet e sipërcituara, pasi ato i përmbushin të tre komponentët, pra si komponentin vlefshmëri (për ato fatura ose zëra të tyre që janë brenda afatit tre vjeçar nga data e publikimit të njoftimit të kontratës) si komponentin ngjashmëri (që kanë objekt apo zëra të ngjashëm në faturat e dorëzuara) dhe si komponentin e vlerës së realizuar. Komisioni i Prokurimit Publik, pasi veçoi dokumentacionin e sipërcituar, i cili i përmbushin të tre komponentët që karakterizojnë një kontratë të ngjashme, pra elementin kohë, elementin vlerë dhe elementin ngjashmëri, vëren të ndalet në elementin ngjashmëri si arsyeja e pretenduar për skualifikimin e operatorit ekonomik “UBI GROUP” SHPK i cili për sa kohë ka dorëzuar të gjitha faturat me objekte " Shërbim Interneti", qartazi sjellë përmbushje të elementit ngjashmëri.

Përsa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “ONE ALBANIA” SHPK nuk qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimin tjetër të operatorit ekonomik “ONE ALBANIA” SHPK, mbi kundërshtimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me kualifikimin e ofertës së paraqitur prej operatorit ekonomik “UBI GROUP” SHPK, me arsyen se: *“Referuar pikes DST 1.3.2 Operatori Ekonomik duhet të jetë i regjistruar pranë regjistrit të AKEP për ofrimin e shërbimit ne territorin e Shqipërisë. Sipas te dhenave nga AKEP, REGJISTRI I SIPËRMARRËSVE QË KANË NJOFTUAR OFRIMIN E RRJETEVE DHE SHËRBIMEVE PUBLIKE TË*

KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE SIPAS REGJIMIT TË AUTORIZIMIT TË PËRGJITHSHËM DERI NË DATË 03.04.2026, operatori Ekonomik UBI Grup sh.p.k nuk është i licensuar për ofrimin e të gjitha shërbimeve objekt prokurimi, vecanerisht shërbimeve të telefonisë si edhe IPTV. Referuar shërbimit IPTV të kërkuar në listën e shërbimeve pjesë e kësaj procedure, ky operator nuk rezultoi të jetë i listuar në REGJISTRIN E SIPËRMARRËSVE QË KANË NJOFTUAR OFRIMIN E RRJETEVE TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE PËR TRANSMETIM AUDIO DHE/OSE AUDIOVIZIVE SIPAS REGJIMIT TË AUTORIZIMIT TË PËRGJITHSHËM PËRDITËSUAR DATË 03.04.2026, si rrjedhojë, OE UBI Group nuk plotëson kriteret e përcaktuara në DST dhe duhet të skualifikohet nga ky tender.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.4.1. Në shtojcën 9 “Formulari i Kriterëve të Përzgjedhjes/Kualifikimit” pika 2.3.3 “Kapaciteti teknik” autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin kualifikues si më poshtë vijon:

2.3.3 “Operatori Ekonomik duhet të jetë i regjistruar pranë regjistrit të AKEP për ofrimin e shërbimit në territorin e Shqipërisë.”

III.4.2. Sa më sipër, referuar kërkesave të vendosura nga autoriteti kontraktor për sa i përket kriterit 2.3.3, si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “UBI” SHPK në sistemin e prokurimeve elektronike, konstatohet se ky i fundit ka paraqitur:

- Certifikatë nga AKEP për rrjete dhe shërbime publike të komunikimeve elektronike të njoftuara në AKEP nga sipërmarrësi UBI GROUP sh.p.k:

A. Rrjete publike të komunikimeve elektronike:

1. Rrjete publike tokësore fikse:

a) Rrjeti i aksesit:

-

b) Rrjeti i transmetimit:

-

c) Zona e njoftuar:

B. Shërbime të komunikimeve elektronike:

1. Shërbimi i aksesit në internet.

Sipërmarrësi i regjistruar për ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve publike të komunikimeve elektronike të mësipërme, i cili operon nën regjimin e Autorizimit të Përgjithshëm, është i detyruar të zbatojë termat dhe kushtet e parashtruara në Aneksin E të Rregullores së Autorizimit të Përgjithshëm.

Në faqen e internetit AKEP publikon një regjistër të përditësuar i të gjithë sipërmarrësve të cilët kanë njoftuar ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike, duke përfshirë informacionin mbi llojet e rrjeteve dhe shërbimeve që ata ofrojnë.

III.4.3. Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm

në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. 2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim. 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.4.4. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet

që do të ofrojnë, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat e cilësisë. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/ kriterëve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi.

III.4.5. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, vërejmë se autoriteti kontraktor në kriteret e veçanta të kualifikimit ka kërkuar shprehimisht që operatori ekonomik duhet të jetë i regjistruar pranë regjistratit të AKEP për ofrimin e shërbimit në territorin e Shqipërisë. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik, nga operatori ekonomik “UBI GROUP” SHPK, konstatohet se ky i fundit ka paraqitur Certifikatën e lëshuar nga AKEP me nr. 2024-AP-1.1_801 / datë 29.05.2024, me përmbajtje si në pikën III.4.2 të këtij vendimi. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar dokumentin e kërkuar dhe është në përmbushje të kriterit të përcaktuar në pika 2.3.3 “Kapaciteti teknik”, të dokumentave të tenderit të procedurës objekt shqyrtimi.

Pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “ONE ALBANIA” SHPK nuk qëndron.

III.5. Lidhur me pretendimin tjetër të operatorit ekonomik “ONE ALBANIA” SHPK, mbi kundërshtimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me kualifikimin e ofertës së paraqitur prej operatorit ekonomik “UBI GROUP” SHPK, me arsyen se: “3. Referuar specifikimeve teknike ku është përcaktuar: Operatori duhet të disponojë AS të regjistruar pranë RIPE NCC (European IP NETWORK). Kjo vërtetohet me certifikatën e regjistrimit përkatëse. Nga një verifikim i thjeshtë si operator në linkun e RIPE NCC, operatori UBI Group nuk rezultoi të disponojë AS të regjistruar pranë RIPE, dhe rrjedhimisht nuk plotëson kriterin e përcaktuar në specifikimet teknike. Sa më sipër Operatori ekonomik nuk e plotëson kriterin lidhur me paraqitjen e certifikates së regjistrimit pranë RIPE NCC dhe rrjedhimisht duhet të skualifikohet nga kjo procedure. 4. Ky operator nuk ka kapacitet dhe nuk arrin të provojë kapacitetin për realizimin e shërbimit DDOS si një nga shërbimet pjesë e formularit të ofertes dhe specifikimeve teknike, dhe

nje sherbim kritik per garantimin e sigurise dhe vazhdimesise se institucionit. Sherbimi DDOS ne kohen qe jetojme eshte nje nga sherbimet me themeltare qe garanton vazhdimesine e sherbimit. Ky operator sic mund te verifikohet lehtesisht ne portalin Open Corporates nuk ka asnje eksperience te meparshme me institucionet publike. Mbrojtja e sigurise kibernetike (DDOS) eshte thelbësore per kete institucion si nje institucion i rendesise se vecante dhe natyres kritike te sherbimeve qe ofron. Sa me siper, operatori qe do te marre persiper kete sherbim do te duhet te provoje eksperiencen dhe ekspertizen e nevojshme ne kete sherbim dhe jo te shfaqe mangesi te dukshme dhe qe kompromentojne realizimin e kesaj kontrate dhe qe mund te cojne ne deshtim te kontrates.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.5.1. Në shtojcën 6 “Formulari i Specifikimeve teknike” autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

“Shtojca 6 .

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

.....

▣ **Referohuni dokumentacionit ngarkuar ne SPE me emertimin 2_ “Specifikimet Teknike”**

SPECIFIKIMET TEKNIKE PER SHERBIM INTERNETI PER 3 VITE

Përshkrimi i Përgjithshëm Autoriteti Portual Durrës me ane te kësaj procedure kërkon ofrimin e shërbimit te internetit te telefonisë dhe te atij televiziv ku prioritet ka zbatimi i standardeve për institucionet shtetërorë ne lidhje me fushën e TIK, me qellim përmirësimin e shërbimit dhe edukimin e përdoruesve. Duke u bazuar ne standardet e përdorimit te internetit ne administratën shtetërore duke u marre shkas rreziqet potenciale, rolin e Autoritetit Portual Durrës (APD) ne forcimin e politikave dhe përfitimin ekonomik, si dhe duke përdorur infrastrukurën e tij te rrjetit, APD do te beje te mundur ofrimin e shërbimit te internetit për te gjitha godinat e zyrat e tij me vendodhje te ndryshme dhe shtrirje ne rreth 80 ha, duke u kthyer ne një nyje te vetme aksesit interneti. Lidhja e qëndrueshme dhe përdorimi i internetit ne Autoritetin Portual Durres eshte i nje rëndësie te veçantë pasi përdoret infrastrukture komunikimi për te aksesuar aplikacione vitale për Portin qe operojnë ne cloud, sic jane sistemi i operimit te Terminalit te Kontejnerëve “NAVIS”, sistemi IT te BI Oracle, etj. Pra lidhjet kërkohe te bëhen ne mënyrë redundante (High Available) për te siguruar një shërbim te vazhdueshëm dhe cilësor 24 ore/ 24 ore ne 7 dite te javës. Gjithashtu si shërbim kritik kërkohet instalimi i një Lidhje Sekondare (Backup Line) me ane te teknologjisë satelitore, ose teknologjie tjetër, ne mënyrë qe te shmange çdo mungese shërbimi. Sa me siper, APD-ja kërkon te blejë shërbim interneti, telefonie dhe te televizionit nga një Operator Shërbimi Internet ISP duke kërkuar nga ky i fundit qe te plotësojë patjetër indikatorët e cilësisë dhe specifikime qe vijojnë me poshtë.

1. SPECIFIKIMET E SHËRBIMIT TE KERKUAR

Specifikime teknike Nr. 1: Lidhja Kryesore (Primary Dedicated Fiber)

Ky shërbim është i dedikuar për operacionet kryesore të portit, ku kërkohet performancë maksimale dhe vonesë (latency) minimale për aplikacionet cloud.

Emërtimi	Madhësia/Lloji
Teknologjia e Transmetimit	Fibër Optike e Dedikuar (Point-to-Point)
Kapaciteti i Bandwidth-it:	Minimumi 1 Gbps simetrik (download/upload)
Garantimi i Bandës	1:1 (Dedicated/Uncontended)
Disponueshmeria e shërbimit (SLA)	≥ 99.99% në muaj,
Tipi i shërbimit	Internet i dedikuar
Adresa IP Publike Statike	10 Adresa IPpublike të përdorshme
Vonesa (Latency)	< 5ms (brenda Shqipërisë), < 40ms (drejt nyjeve kryesore në BE)
Jitter	<2ms
Maximum packet loss	<0,1%
Mbështetja Teknike	24/7/365 me kohë reagimi < 1 orë
Mbrojtje DDoS	Max. 800Mbps clean traffic, smart mitigation.
IPTV	Tring dhe Digitalb, 6 Poste
Lidhje telefonike për institucionin	SIP Trunk (min 30 thirrje te njëkohshme- Concurrent Calls)
Numra telefoni fix virtual për zyrat te terminuar ne PBX	100 numra

Specifikime Teknike Nr. 2: Lidhja Rezervë dhe Redundanca (Backup/Redundant Link) për te garantuar vazhdimësinë e punës dhe telefonisë në rast defekti të linjës kryesore.

Emërtimi	Madhësia/Lloji
Teknologjia e Transmetimit	Microwave Link (Radio)/satelit ose Fibër Optike (Rrugë alternative) ose ekuivalente
Kapaciteti i Bandwidth-it:	Minimumi 200 Mbps simetrik (download/upload)
Garantimi i Bandës	1:1 (Dedicated/Uncontended)
Disponueshmeria e shërbimit:	≥ 99.7% në muaj,
Adresa IP Publike Statike	10 Adresa IP publike të përdorshme)
Vonesa (Latency)	< 15ms (brenda Shqipërisë), < 60ms (drejt nyjeve kryesore në BE)
Jitter	<2ms
Maximum packet loss	<0,5%

2.NIVELI I SHERBIMIT

1. Siguria e Rrjetit

Operatori duhet të dijë paraprakisht që lidhja e ofruar prej tij do të ndahet në disa godina të tjera. Në rast sulmesh apo identifikimin të viruseve apo maleëare-ve nga ana e rrjetit të APD se, operatori duhet të lajmëroje në mënyrë sa më të shpejte APD-ne për problematiken dhe të bashkëpunojnë për zgjidhjen e problemit.

2. Instalimi I lidhjes

Lidhja e shërbimit do të merret përsipër nga kompania, Operatori i Shërbimit ISP:

- Kjo lidhje do të jete e dedikuar nga kompania drejt APD dhe do të jete me fibër optike.*
- Kompania duhet të siguroje të gjithë aksesoret e nevojshëm dhe shërbimet teknike për realizimin e saj pranë APD.*
- Në rast defektesh, kompania është përgjegjëse për mirëmbajtjen në eficence të kësaj lidhjeje.*
- Kompania nuk mban përgjegjësi për çështje të rrjetit të brendshëm të APD. Infrastruktura dhe asetet e lidhjes janë prone e kompanive që do ta kryejnë atë.*
- Në rast të ndërprerjes së kontratës ajo është e detyruar të marrë mbrapsht të gjitha asetet eventuale që do të ndodhen pranë infrastrukturës së Autoritetit Portual Durrës.*




Figure 1. Skema logjike e lidhjes

2. Shërbimi teknik

Operatorët Ekonomike, Kompanitë duhet të paraqesin në oferte termat e suportit dhe kontaktet për asistencë teknike, e cila duhet të jetë 24 ore, në 7 ditët e javës, 365 dite. Gjithashtu:

- Koha maksimale e përgjigjes ndaj defekteve të mundshme, pra koha maksimale gjatë së cilës do të kryhet përcaktimi i problemit do të vendoset afati i përafërt i zgjidhjes së tij është 10 min.
- Koha maksimale e zgjidhjes së problemit, e cila nuk merr parasysh rastet e forcave madhore, nuk duhet të jetë me shumë se 150 min.

Asistenca në vend pranë APD nuk do të përfshijë kosto shtese. Kompania nuk do të përgjigjet me asistencë teknike në rast se problemet teknike do të shfaqen në infrastrukturen e brendshme të APD.

Shenim: Pajisjet dhe fibrat optike që duhen për lidhjen primare dhe për lidhjen sekondare (backup) do të terminojnë dhe instalohen në dhomë të serverëve të APD, që ndodhet në godinën e Drejtorisë Ekzekutive të APD-së me adresë: Rr, " Tregtare Nr1. Durrës.

-Gjithashtu në shtojcën 7 “Formulari i shërbimeve dhe grafikut të ekzekutimit” “autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

“Shtojca 7.

(Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimet që kërkohen që kërkohen:

Afatet e ekzekutimit:

Shërbimet	Përshkrimi	Sasia	Vendi i ekzekutimit	Afati i ekzekutimit
Internet i Dedikuar (Primary)	Përfshire mbështetjen 24/7	1	Autoriteti Portual Durres	3 vite
Internet Rezervë (Backup)	Përfshire mbështetjen 24/7	1	Autoriteti Portual Durres	3 vite
Adresa IP Publike (Primary) te përdorshme		10	Autoriteti Portual Durres	3 vite
Adresa IP Publike (Backup) te përdorshme		10	Autoriteti Portual Durres	3 vite
Shërbim Mbrojtjeje nga sulmet DDoS për infrastrukturën e APD	Përfshire monitorim 24/7 dhe mitigim automatik	1	Autoriteti Portual Durres	3 vite
IPTV	Tring dhe Digitalb, 6 Poste	6	Autoriteti Portual Durres	3 vite
SIP Trunk (Kanale)	30 Thirrje të njëkohshme (Concurrent Calls)	30	Autoriteti Portual Durres	3 vite
Shërbim Telefonie Numra Fiks Virtual për 100 numra aktivë	Përfshire thirrjet brenda rrjetit dhe drejt operatorëve kombëtarë	100	Autoriteti Portual Durres	3 vite

III.5.2. Sa më sipër, referuar kërkesave të vendosura nga autoriteti kontraktor për sa i përket shtojcës 6 dhe shtojcës 7, si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “UBI Group” SHPK në sistemin e prokurimeve elektronike, konstatojmë se ky i fundit ka paraqitur:

- Shtojcën 6 të formularit të specifikimeve teknike të firmosur dhe vulosur sipas kërkesave të autortietit kontraktor, si dhe deklarat_mbi_permbushjen_e_specifikimeve_teknike të mëvetësishme.

- Gjithashtu ka dorëzuar shtojcën me listen e cmimeve dhe elementet përbërës të shërbimit në të cilin vërehen shërbimet e kërkuara në shtojcën 7.

III.5.3. Në nenin 36 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

“Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.

Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.

Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u

referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.”

III.5.4. Gjithashtu, në nenin 4 paragrafi 38 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet “Specifikime teknike” janë: “b) në rast të prokurimit publik të mallrave ose shërbimeve, specifikimi me të cilin përkufizohen karakteristikat e prodhimit ose shërbimit, siç janë niveli i cilësisë, ndikimi mbi mjedisin jetësor dhe ndikimet klimatike, përshtatshmëri të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe arritshmëri për persona me aftësi të kufizuara dhe vlerësim të përputhshmërisë, niveli i realizimit, shfrytëzim i prodhimit, siguri ose dimensione, duke i përfshirë edhe kërkesat relevante për produktin në raport me emërtimin me të cilin shitet, terminologjinë, simbolet, testimet dhe metodat për testim, paketimin, shënimin dhe etiketimin, si dhe udhëzime për përdorim, proceset dhe metodat e prodhimit në secilën fazë të jetëgjatësisë së mallrave dhe shërbimeve, si dhe procedura për vlerësim të përputhshmërisë.”

Në nenin 124 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, “Detyrimet e autoritetit ose entit kontraktor gjatë zbatimit të kontratës” përcaktohet: “1. Autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të ndjekë zbatimin e kontratës sipas kushteve në bazë të të cilave është nënshkruar, për të garantuar se ajo zbatohet në kohën, cilësinë dhe vlerën e përcaktuar, në përputhje me kushtet e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe me legjislacionin në fuqi. 2. Për monitorimin e zbatimit të kontratave të lidhura në përfundim të procedurave me vlerë mbi kufirin monetar të prokurimeve me vlerë të vogël, të cilat kanë kohëzgjatje jo më pak se 6 muaj, autoriteti ose enti kontraktor, nisur nga natyra e objektit të kontratës dhe kohëzgjatja e zbatimit të saj, harton planin e zbatimit të kontratës, duke përfshirë në veçanti çështjet organizative, afatet, çështjet ekonomike e teknike të kontratës së nënshkruar, në përputhje me çdo akt tjetër ligjor. 3. Planin e zbatimit të kontratës duhet të nënshkruhet nga autoriteti ose enti kontraktor dhe operatori ekonomik brenda 10 ditëve nga nënshkrimi i kontratës. Planin e zbatimit të kontratës duhet të nënshkruhet nga autoriteti ose enti kontraktor dhe operatori ekonomik në Sistemin e Menaxhimit të Kontratave. 4. Çdo modifikim i kontratës në përputhje me nenin 127 të këtij ligji, pasqyrohet në planin e zbatimit. 5. Autoriteti ose enti kontraktor, në përputhje me planin, ndjek zbatimin e kontratës, administron dokumentacionin e monitorimit dhe harton raportet e monitorimit në Sistemin e Menaxhimit të Kontratave. 6. Rregulla të hollësishme për monitorimin e zbatimit të kontratave, përcaktohen nga rregullat e prokurimit publik. Autoriteti kontraktor duhet të kryejë pagesat në favor të operatorëve ekonomikë, në përputhje me parashikimet e legjislacionit të fushës në fuqi.

III.5.5. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, autoritetet kontraktore në hartimin e specifikimeve teknike, krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në

vëmendje faktin se, hartimi i specifikimeve teknike duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse duke krijuar kushte për konkurrin të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës. Për këtë qëllim ligjvënësi ka parashikuar, se këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor, edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore, nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Ligjvënësi ka parashikuar qartësisht në nenin 36 pika 1 paragrafi 4 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, se duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. Në respekt të parimit të mësipërm, specifikimet teknike, në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përjashtojnë nga konkurrimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit qofshin këta kombëtar apo ndërkombëtarë. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, qoftë ato të dukshme, qoftë ato të fshehta, të cilat kanë të njëjtin efekt. Në asnjë rast, specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/malli/shërbimi, që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm. KPP gjykon, se parashikimet e mësipërme duhet të zbatohen në të gjitha procedurat e prokurimit, me përjashtim të rasteve ku vetë ligji i prokurimit publik, parashikon një përjashtim të tillë. Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin, se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP dhe që i vlerëson punët/mallrat/shërbimet si të pranueshme për funksionet e kërkuara. KPP gjykon, se në rastin konkret operatori ekonomik “UBI GROUP” SHPK ka dorezuar deklaratat dhe shtojcat sipas specifikimeve të kërkuara nga autoriteti kontraktor dhe rrjedhimisht ka përmbushur shtojcen 6 dhe shtojcen 7 të dukemtave të tenderit dhe me të drejtë autoriteti kontraktor e ka pranuar si të plotësuar këtë kërkesë por akoma më tej në nenin 124 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, ligjvënësi ka parashikuar dhe detyrimet e autoritetit gjatë zbatimit të kontratës ku qartazi përcaktohet në pikën 1 të saj se *Autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të ndjekë zbatimin e kontratës sipas kushteve në bazë të të cilave është nënshkruar, për të garantuar se ajo zbatohet në kohën, cilësinë dhe vlerën e përcaktuar, në përputhje me kushtet e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe me legjislacionin në fuqi*, duke i lënë kështu një detyrë autoritetit kontraktor edhe në fazën pas lidhjes së kontratës si garanci për zbatimin e saj nga operatorët ekonomik fitues në përputhje me kushtet dhe specifikat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe me legjislacionin në fuqi.

Pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “ONE ALBANIA” SHPK nuk qëndron.

III.6. Lidhur me pretendimin tjetër të operatorit ekonomik “ONE ALBANIA” SHPK, mbi kundërshtimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me kualifikimin e ofertës së paraqitur prej operatorit ekonomik “UBI GROUP” SHPK, me arsyen se: *“Gjithashtu, si një nga operatorët me më shumë eksperience në treg, nga analiza e ofertës ekonomike rezulton se diferenca midis ofertës së UBI Group dhe operatorëve të tjerë të kualifikuar është ndjeshëm më e ulët krahasuar me natyrën dhe kompleksitetin e shërbimeve të kërkuara, çka ngre dyshime serioze mbi*

realizueshmërinë teknike dhe financiare të kontratës sipas specifikimeve të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor. Nga sa me sipër, në kushtet kur UBI Group nuk ka provuar zotërimin e infrastrukturës së nevojshme për ofrimin e shërbimeve objekt prokurimi, eksperiencë të mëparshme të ngjashme në kontrata telekomunikacioni të kësaj natyre dhe kompleksiteti, kapacitete teknike dhe profesionale për implementimin e shërbimeve SIP trunk, IPTV, DDoS Protection dhe IP publike, apo autorizime/licenca të plota dhe të përshtatshme për ofrimin e këtyre shërbimeve, kualifikimi i këtij operatori ekonomik është bërë në kundërshtim me kriteret e kualifikimit dhe me parimin e proporcionalitetit dhe sigurisë teknike që kërkon natyra e kontratës, cka rrezikon realizueshmërinë e kësaj kontrate në teresi. Disa nga elementet thelbësore që e bejne te pa kualifikueshem kete operator jane: , mungesa e një backbone/rrjeti të vet telekomunikacioni ose mungesa e provës për kapacitete transit dhe peering; , mungesa e NOC (NETWORK Operations Center) funksional 24/7 për monitorim dhe menaxhim incidentesh; , mungesa e kapaciteteve për redundancë dhe high availability (backup links, failover, geo-redundancy); , mungesa e platformave/probeve për mitigim DDoS ose mungesa e partneriteteve teknike të dedikuara për këtë shërbim , mungesa e licensimit dhe rregjistrimit perkates per shërbimet e kerkuara ne tender sic jane ato te telefonise fikse dhe IPTV. , , Mungesa e rregjistrimit ne RIPE NCC. Mungesa e kontratave te ngjashme Në këto kushte, ONE Albania, si operator me interes të ligjshëm në këtë procedurë, kundërshton kualifikimin e operatorit ekonomik UBI GROUP.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se, për sa kohë pretendimet mbi specifikimet teknike të shtojcës 6 dhe mbi kërkesat e shtojcës 7 të dokumentave të tenderit janë trajtuar dhe gjykuar në pikën III.5 e në vijim të këtij vendimi dhe vetë pretendimi i operatorit ekonomik ankimes konsiston në thelb mbi specifikimet dhe grafikun e ekzekutimit të tyre , të mos ripërsërisë veten me trajtimin e kësaj pike të pretenduar të ripërsëritur.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “NISATEL” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-83798-04-29-2026, me objekt “Shërbim interneti për 3 vite”, me fond limit 5,420,339.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 11-05-2026 nga autoriteti kontraktor Autoriteti Portual Durres.

2. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “ONE ALBANIA” SHPK, për procedurën e prokurimit të sipërcituar.
3. Autoriteti kontraktor të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
4. Ngarkohet zyra e financës, të bëjë kalimin në buxhetin e shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “NISATEL” SHPK.
5. Ngarkohet zyra e financës, të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “ONE ALBANIA” SHPK.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Edvin Simo

Anëtar
Nertil Kanina

Kryetar
Ismail Shehu

